

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË
KËSHILLI BASHKISË

V E N D I M

Nr. 161 Datë 28/12/2017

**Për zgjerimin e zonës TID , Zona e Zhvillimit të Turizimit nga Qendra e Krujës-Rruga
“Pazari i Vjeter” deri në hyrjen e Kalasë Krujë.**

Në zbatim të ligjit me nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, mbi nenin 8 ligjit 93/2015 “Për Turizmin”.Ligjit nr.10352,datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar,VKM nr.510 datë 18.07.2012” Për trashëgiminë Kulturore” dhe mbi akt marrëveshjen e lidhur mes bashkisë Krujë dhe Kruja InfoPoint me datë 01/07/2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen mes bashkisë Krujë dhe subjektit “Kruja InfoPoint” mbi administrimin e Zyrës së Informacionit Turistik .
2. Bashkia Krujë do marrë përsipër pagesën e qeresë mujore të Zyrës së Informacionit Turistik.
3. Zyra e Informacionit “Kruja InfoPoint” do shërbejë si pike zyrtare informacioni për bashkinë Krujë.
4. Zyra e Informacionit “Kruja InfoPoint” do organizojë dhe promovojë turizmin në koordinim me Zyrën e Turizmit në bashkinë Krujë.
5. Te ngarkohet për ndekjen e zbatimit të projektit Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 diteve nga miratimi i tij.

Kryetari i Këshillit

Hysni Caca

Në Mungesë

ZV/Kryetari

Artur KARAJ

